



Pranimi - Datozuar Pranimi - Prilaziti Pranimi - Prilaziti	13.11.2020	viti god year	0
Udhëzimi Udhëzimi Udhëzimi	SKRMBICK	Shirpa Udhëzimi Udhëzimi	2592/2020
		Sasia Kufizimi Quantity	114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.275/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.275/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Valdrin Behrami me adresë rruga Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", H3, Nr.1, në Ulpianë/Prishtinë, kundër Vendimit me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "pezullim nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.11.2020, mori këtë

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020, i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
- II. OBLIGOHET Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj lëndën lidhur me „pezullimin nga marrëdhënia e punës“ sipas kërkesës të datës 18.09.2020 të parashtruar nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Me datë 09.09.2020 Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka nxjerr vendim me numër 01.Ref.Nr.20 me të cilin e ka pezulluar nga detyra me 50% të pagës ankuesin [REDACTED] Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu me datë 18.09.2020 ka dorëzuar shkresën-kërkesën për Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë z. [REDAKTUAR] për shkak të shkeljeve të rënda të detyrës zyrtare.

Ankuesi [REDAKTUAR] i pakënaqur me vendimin me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me datë 18.09.2020 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 23.09.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Këshilli më datë 01.10.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, më datë 02.11.2020 ka nxjerr vendimin VK.nr.14/2020 përmes të cilit ka vendosur të shtyhet afati i vendosjes për ankesën A.nr.275/2020 edhe për dhjete (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 18.09.2020 me numër protokolli 1813/2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Vendimin me Nr.03/07 të datës 22.06.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Autorizimin për përfaqësim të avokatit; Kërkesën e datës 18.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; E-mailin e datës 18.09.2020 nga Gazmend Mejzini për Rexhep Bllaca; E-mailin e datës 17.09.2020 nga Rexhep Bllaca për Gazmend Mejzini; Vendimin e datës 29.06.2020; E-mailin e datës 29.06.2020 nga Gazmend Mejzini për [REDAKTUAR] Emërimi dhe Fletë deponimi i nënshkrimeve; Vendimin e datës 03.03.2020; Kontratën Publike Kornizë; Kërkesën e datës 21.08.2020; E-mailin e datës 11.09.2020 nga Blerim Ibrahimini për Gentiana Islamaj; E-mailin e datës 31.08.2020 nga Blerim Ibrahimini për [REDAKTUAR]; E-mailin e datës 31.08.2020 nga Burim Koraqi për Blerim Ibrahimini; E-mailin e datës 31.08.2020 nga Belrim Ibrahimini për Burim Koraqi; Planin e implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019; Vendimin Nr. Prot 5874, Nr. Prot 5879, Nr. Prot 5873, Nr. Prot 5871, Nr. Prot 5876, Nr. Prot 5880, Nr. Prot 5878, Nr. Prot 5877 të datës 04.09.2020; Përgjigje në ankesë e datës 01.10.2020; Njoftimin e datës 28.09.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesin; Kërkesën e datës 09.10.2020 nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kërkesën e datës 02.11.2020 dhe Vendimin me numër VK.nr.14/2020 të datës 02.11.2020 për shtyrje të afatit për vendosje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesi dhe po ashtu edhe nga organi i punësimit dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda të kthehet në rishqyrtim, duke obliguar Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, për t'i ndërmarr të gjitha veprimet për ta rishqyrtuar lëndën lidhur me çështjen e „pezullimit nga marrëdhënia e punës“ të ankuesit Burim Rreci.:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me Vendimin Nr.11/26 të datës 29.01.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me mandat 3 vjeçar. Ndërsa me Vendimin Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi është ri caktuar në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, deri në përfundimin e mandatit sipas vendimit Nr.11/26 të datës 29.01.2018. Ankuesi me datë 09.09.2020 përmes vendimit me numër 01.Ref.Nr.20 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës së tij.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore për shqyrtimin e ligjshmërisë në shërbimin civil, ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 me të cilin i ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullim nga detyra me 50% të pagës deri në marrje të vendimit tjetër. Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ky vendim nuk është nxjerr në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht me nenin 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse në mënyrë taksative janë përcaktuar rastet kur një nëpunës civil pezullohet nga marrëdhënia e punës, sipas detyrës zyrtare.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me Vendimin me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020, me të cilin i ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullimin nga detyra me 50% të pagës ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin përcaktohet se: *... komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar* sepse në rastin konkret vetëm Komisioni Disiplinor, respektivisht Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë mund të pezulloj nëpunësin civil te nivelit të lartë drejtues për shkelje të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 lidhur me pezullimin nga detyra me 50% të pagës së tij deri në marrje të vendimit tjetër, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave dhe dëshmimeve të bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, njëkohësisht me vendimin për pezullimin nga detyra të ankuesit, me datë 18.09.2020 ka dorëzuar edhe shkresën-kërkesën për Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ku ka kërkuar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë z. [REDAKTUAR] për shkak të shkeljeve të rënda të detyrës zyrtare.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se bazuar në dispozitat e nenit 49 të Ligjit për Zyrtarët Publik, kompetencat e komisionit disiplinor, për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese në institucionin e administratës shtetërore, ushtrohen nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. Andaj, Kolegji vlerëson se Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë pas shqyrtimit

të kërkesës së Ministrit duhet të konstatoje saktë dhe duke u mbështetur me fakte arsyet në rast se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ankuesi e pengon hetimin disiplinor apo jo, dhe mbi bazën e konstatimeve të nxjerr vendim me të cilin vendose lidhur me „pezullimin nga marrëdhënia e punës“ të ankuesit apo për ndonjë mase tjetër ashtu siç parashihet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 48 paragrafi 5, ku përcaktohet se: Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Prandaj marrë parasysh nga ajo që u tha në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji për shqyrtimin e ankesave nuk është lëshuar në trajtimin e lëndës në përmbajtje, sepse është konstatuar se Vendimi i Ministrit të MTI-së ka lëshime procedurale të tilla që nuk lejojnë trajtimin e tij, Kolegji duke mos paragjykuar përgjegjësin disiplinore të ankuesit, obligon Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë që te veprojnë konform dispozitave ligjore të lartshënuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, me shumicë të votave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi. Anëtari i Kolegjit i cili ka dhënë mendim mospajtues me këtë vendim, duhet të jap me shkrim mendimin mospajtues dhe i njëjti duhet t'i bashkëngjitet dosjes së lëndës

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.275/2020

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Valdrin Behrami;
- Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Sekretariatit të Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



Pranuar / Datedur / Prilapen / Prilato / Received / Delivered	13.11.2020	viti / god / year	0
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org. Unit	In Proti / In Proti / Prot No	Shënjë / Filog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKOMSTEK	2592/a	2020	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.275/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Jeton Koca, anëtar i Kolegjit për shqyrtimin e ankesës A.nr.275/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Valdrin Behrami me adresë rruga Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, H3, Nr.1, në Ulpianë/Prishtinë, kundër Vendimit me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “pezullim nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 17 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.11.2020, paraqet këtë

MENDIM MOSPAJTUES me

Vendimin e Kolegjit për shqyrtimin e ankesave në rastin e shqyrtimit të ankesës A.nr.275/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

Arsyetim

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.275/2020 të datës 18.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], kundër Vendimit me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “pezullim nga marrëdhënia e punës”. Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe pas diskutimeve të mbajtura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me shumicë të votave ka marr vendim me të cilin:

SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020, i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

II. OBLIGOHET Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj lëndën lidhur me „pezullimin nga marrëdhënia e punës” sipas kërkesës të datës 18.09.2020 të parashtruar nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Bazuar në dispozitat e nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe dispozitat e nenit 17 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në cilësinë e anëtarit të Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, në seancën për këshillim dhe votim, me respekt ndaj dy anëtarëve që kanë përbë shumicën në Kolegji, kam dhënë mendim mospajtues lidhur me vendimin A.nr.275/2020 të datës 13.11.2020, për arsyet e ofruara si në vijim:

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullim nga detyra është nxjerr nga organi jo kompetent, Kolegji për Shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar në mënyrë unanime se me dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë përcaktuar në mënyrë taksative rastet kur një nëpunës civil pezullohet nga marrëdhënia e punës, sipas detyrës zyrtare. Kolegji ka vlerësuar së nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues, për shkelje të detyrave të punës mund të pezullohet vetëm nga Komisioni Disiplinor, respektivisht Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, siç parashihet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 48 paragrafi 5, ku përcaktohet se: *Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.* Përfundimisht në rastin e inicimit të procedurës disiplinore, ku kompetent për pezullimin e nëpunësit civil është Komisioni Disiplinor, në të gjitha rastet tjera të përcaktuara në dispozitat e nenit 56 të Ligjit për Zyrtar Publik, kompetent për konstatimin e shkakut të pezullimit për nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e administratës shtetërore, është ministri përgjegjës për administratën publike, kështu që Kolegji ka konstatuar së pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se vendimi për pezullim nga detyra është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë procedurën disiplinore, ka konstatuar në mënyrë unanime së sipas dispozitave të nenit 48 paragrafi 2 të Ligjit për Zyrtarët Publik, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është i detyruar të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, dhe është kompetent të shqiptojë vetëm masën disiplinore të vërejtjes, ndërsa për shqiptimin e të gjitha masat tjera disiplinore të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit për Zyrtarët Publik, kompetent është Komisioni Disiplinor, ndërsa për pozita të nivelit të lartë drejtues kompetent është Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. Andaj, Kolegji në mënyrë unanime ka vlerësuar së Ministri i Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, me rastin e nxjerrjes së vendimit për pezullimin nga detyra të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-

114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 48 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, dhe paragrafin 5 ku përcaktohet se: ... komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.* Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se në këtë rast, ankuesit iu ka mohuar e drejta për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejtë kjo e garantuar me nenin 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Kolegji në mënyrë unanime ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullim nga detyra, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu në mënyrë unanime ka konstatuar së struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe ka vlerësuar se Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullim është në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kolegji në mënyrë unanime ka konstatuar së pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Pra, siç shihet në pjesën arsyetuese të vendimit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në mënyrë unanime ka konstatuar së Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullimin e ankuesit nga detyra me 50% të pagës, është nxjerr nga organi jo kompetent; në kundërshtim me procedurën e përcaktuar administrative; dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, dhe ka aprovuar pretendimet e ankuesit si të bazuar.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 52 paragrafi 1 i cili përcakton se një akt administrativ është i paligjshëm, nëse: *1.2 organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë, 1.3 është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe 1.4 është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ,* në cilësinë e anëtarit të Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konsiderojë së konstatimi i anëtarëve tjerë që përbejnë shumicën në Kolegj, se ka bazë ligjore që vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullimin e ankuesit nga detyra të shfuqizohet dhe rasti të kthehet në ri shqyrtim në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 53 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave në rast kur konstaton se pretendimet e palës janë të bazuara duhet të aprovoje ankesën dhe të anulojë apo shfuqizojë aktin administrativ i cili është goditur me ankesë. Andaj, duke marr parasysh së

pretendimet e ankuesit lidhur me shkeljet procedurale janë aprovuar si të bazuara, konsideroje se Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullimin e ankuesit nga detyra është dashur të anulohet, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë siç përcaktohet me nenin 53 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa lidhur me detyrimin e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë që ta ri shqyrtoje lëndën e ankuesit lidhur me çështjen e "pezullimit parandalues", në cilësinë e anëtarit të Kolegjit konsideroje se kjo pike e dispozitivit të vendimit nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 për pezullimin parandalues nuk është vendim i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, kështu që vlerësojë se Kolegji nuk mund ta detyrojë një organ tjetër që ta ri shqyrtojë lëndën, për të cilën lëndë ai organ nuk ka vendosur.

Pra, derisa Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 të shpallet i paligjshëm, në cilësinë e anëtarit të Kolegjit, vlerësojë se nuk ka bazë ligjore që rasti të kthehet në ri shqyrtim në Komisionin për Vlerësim dhe Disiplinë, mirëpo ekziston baza ligjore që ankesa e ankuesit të aprovohet dhe Vendimi 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 të anulohet, andaj mbi këtë bazë, mendimi im në Kolegji ka qenë që të:

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa më numër A.nr.275/2020 e datës 18.09.2020 e parashtruar nga ankuesi ██████████
- II. **ANULOHET** Vendimi me numër 01.Ref.Nr.20 i datës 09.09.2020 i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
- III. **OBLIGOHET** Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të kthejë në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, ankuesin ██████████ sipas vendimit me Nr.03/07 të datës 22.06.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.275/2020


Anëtar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Valdrin Behrami;
- Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.